

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE**, - Departamenti i Krimeve te Renda-Gjyqtarit Burim Ademi – Kryetar i Trupit Gjykues, me procesmbajtësen Xhemile Babatinci, ndaj te pandehurit [REDACTED] nga Vushtrria, për shkak te veprës penale Prodhim dhe përpunim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge apo veglave pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 te KPRK-se, sipas Aktakuzës se P.T.H. ne Mitrovica PP.I.nr.04/2015 te datës 04.05.2017, pas mbajtjes se shqyrimit fillestar me dt. 26.10.2017, pas mbajtjes se shqyrimit fillestar me dt. 26.10.2017, ne mungese te prokurorit Njazi Rexha dhe, e ne mungese te mbrojtësit te te pandehurit av.Agim Lushta, e ne prezence te të pandehurit [REDACTED] me date 31.10.2017 dite publikisht shpalli, ndërsa me dt.17.11.2017 përpiloj këtë:

### A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: [REDACTED] nga i ati [REDACTED] e ema [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] i lindur me dt. 15.08.1994 ne Vushtrri ku edhe jeton rruga [REDACTED], me nr. personal [REDACTED] shqiptar, shtetas i Republikës se Kosovës, ka te kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes se dobët ekonomike, ndaj tij zhvillohet edhe një procedure tjeter penale per natyre te njejte te veprës penale.

#### Është Fajtor

Sepse: Gjate muajit Prill 2014 ne oborrin e shtëpisë se tij ne Vushtrri ne rrugën “[REDACTED]” pa autorizim ka kultivuar bimën e kanabisit dhe atë 1 (një) bime te kanabisit te lartësisë 150 cm, dhe 1 (një) bime tjeter te kanabisit ne vazo te vendosur ne dritaren e dhomës se tij ne lartësi 20 cm, te cilat janë konfiskuar nga policia e gjithashu gjate kontrollit te policisë ne dhomën e tij është gjetur marijuan 0.4 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale Prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope dhe analoge apo veglave pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 te KPRK-ës

Andaj gjykata, ne mbështetje te dispozitave ligjore e nenin 4,7,9,10,21,41,45,46,62,69,73,75 dhe 274te KPRK-ës, dhe 248 par.1 lidhur me par.4,365,450 dhe 463 te KPP-se, e:

### G J Y K O N

- I. ME DENIM BURGU NE KOHEZGJATJEJE PREJ 6 (gjashte) muaj i cili dënim do te ekzekutohet pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

- II. ME GJOBË NË SHUMË PREJ 300 (treqind) Euro, te cilën gjobe i njëjtë është i obliguar qe ta paguaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi ne afat prej 15 ditësh. Ne rast se nuk e paguan gjobën e njëjta do ti zëvendësohet me burg ku 1 (një) dite do ti llogaritet 20 Euro.
- III. Ne mbështetje te nenit 282 te KPP-es dhe nenit 62 e 69 te KPRK-ës, te pandehurit i shqiptohet: DËNIMI PLOTËSUES  
Konfiskohet substanca narkotike te llojit marihuan (dy bimë) dhe substanca me peshe prej 0.4 gram. Policia është e obliguar qe këtë substancë narkotike ta shkatërroj.
- IV. I pandehuri obligohet qe te paguaj ne emër te paushallit gjyqësor shpenzimet ne lartësi prej 30 Euro pas plotfuqishmërisë se aktgjykimit ndërsa shpenzimet tjera për shpenzimet tjera gjykata do te vendos.
- V. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

#### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovice - ka ngritur aktakuze PP.I.nr.04/2015 te datës 04.05.2017, kundër te pandehurit [REDACTED], për shkak te veprës penale Prodhim dhe përpunim i pa autorizuar i narkotikeve, substancave psikotropike dhe analoge apo veglave pajisjeve apo materialeve narkotike nga neni 274 par.1 te KPRK-se.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar ashtu qe ne këtë seance i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale dhe ka shprehur keqardhje për veprimet e ti.

Prokurori lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka dhënë mendimin për pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit duke propozuar qe gjykata ta pranoj fajësinë e te pandehurit pasi qe pranimi i fajësisë është i mbështetur ne provat materiale qe gjinden ne shkresat e lendet e qe janë propozuar na aktakuze.

Gjithashtu prokurori lidhur me dispozitat për zbutjen e dënimit ka deklaruar se ketë çështje e leme ne vlerësim te gjykatës qe ne baze te provave qe disponon te vlerësoj vet gjykata se a ka vend për aplikimin e dispozitave për zbutjen e dënimit.

Mbrojtësi i te pandehurit [REDACTED] av. Agim Lushta lidhur me pranimin e fajësisë se te mbrojturit te tij ka deklaruar: meqenëse klienti im pas konsultimit te mjaftueshëm me mua ka pranuar faktin e kryerjes se veprës penale e cila mbështet edhe ne provat konkrete, i propozoj gjykatës qe ta pranoj pranimin e fajësisë dhe me rastin e shqyrtimit te dënimit ti ketë parasysh rrëthanat lehtësuese se i njëjtë është i moshës se re, është konsumues i substancave dhe rrëthanën e pranimit te fajësisë.

Gjithashtu mbrojtësi i te pandehurit lidhur me dispozitat për zbutjen e dënimit ka dekluaruar qe e përkrah fjalën e prokurorit dhe gjykata te gjej arsyeshmërinë për aplikimin e këtyre dispozitave.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte ne përputhje me nen 248 pasi qe i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bene ne mënyrë vullnetare se aktakuza nuk përmban shkelje te qarte ligjore apo gabime faktike qe do te bënин te pamundur qe gjykata te beje vlerësimin e pranimit te fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur ne faktet e çështjes qe përbanakuza si: procesverbalin mbi bastisjen e banese dhe personave te datës 25.08.2014, raportin e këqyrjes se vendit te ngjarjes te datës 25.08.2014, raportin e ekspertizës-njësia e shkencave ligjore, analiza kimike me numër referues AKF/ [REDACTED] te datës 08.12.2014, deklaratën e te pandehurit si dhe dokumentacionin ne vendin e ngjarjes, te gjitha këto për gjykatën për veç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë me përputhjen e pranimit te fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e te pandehurit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se kjo vepër penale është e dënueshme me dënim me gjobe dhe dënim me burgim prej 1(një) vjet deri ne 10 (dhjete) vjet, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese, si rrethane lehtësuese gjykata kishe vlerësuar: shkallen e përgjegjësisë penale qe rezulton se si shkalle e përgjegjësisë penale ne rastin konkret ishte dashja direkte qe konsiston ne shkallen me te larte te përgjegjësisë penale. Si rrethane tjetër renduese gjykata ka vlerësuar rrethanat ne te cilat është kryer vepra penale, rrethane tjetër renduese gjykata ka vlerësuar intensitetin e rrezikimit apo te dëmtimit te vlerës se mbrojtur, gjë qe siç rezulton kjo vepër penale ka si synim ruajtjen ne përgjithësi te shoqërisë nga substancat narkotike për derisa ato ligjërisht janë shpallur si te ndaluara me arsyen se përbejnë rrezik për shëndetin e njeriut. Si rrethane lehtësuese gjykata kishte vlerësuar: rrethanat personale te kryerësit dhe sjelljen e tij pas kryerjes se veprës penale, është i moshës se re dhe është mbajtës i familjes se jeton vetëm me nënën e tij qe vetëm ai kujdeset për te, ndërsa përvëç kësaj gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese nga ana tjetër për veç pendimit qe ka pasur i pandehuri ku kjo shihet nga deklarimi i tij ne seance ku aty ka premtuar se ne te ardhmen nuk do te përsëris veprime inkriminuese, si dhe rrethane lehtësuese gjykata e vlerëson pranimin e fajësisë se te pandehurit.

Gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrethana ka gjetur se ekziston baza ligjore për aplikimin e zbutjes se dënimit, me konkretisht bazuar ne nenin 75 par.1 nen par.1.1 dhe 1.3 te KPRK-ës. Nen këto rrethana gjykata ka aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit ndaj te pandehurit, duke pasur për baze faktin se vepra penale për te cilën është shpallur fajtor është e dënueshme me dënim me gjobe dhe me burg prej 1(një) viti deri ne 10(dhjete) vjet, e duke aplikuar dispozitat për zbutjen e dënimit kjo gjykate ka vlerësuar po ashtu edhe një rrethanë te theksuar nga vet i pandehuri se ai jeton vetëm me nënën e tij qe sipas te pandehurit nuk ka se kush te kujdeset për te, andaj gjykata ndaj te

pandehurit ka shqiptuar dënimin me burgim nen minimumn e parapare ashtu qe ju ka përcaktuar dënimin me burg prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobe ne shume prej 300 (treqind) euro.

Nga gjitha këto gjykata duke vlerësuar te gjitha këto rrrethana ka gjetur se edhe me një dënim te tillë do te arrihet qëllimi i dënitit ndaj te pandehurit pasi qe për gjykatën ne rrrethana te tillë mjafton se tërheqja e vërejtjes me kërcënimin e dënitit do te ndaloj kryerësin qe te mos kryej vepra penale ne te ardhmen e qe ky është edhe qëllimi i dënitit me kusht.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur vetëm për paushallin gjyqësor ashtu qe duke u bazuar ne nderlikushmerinë e çështjes penale te pandehurin e ka detyruar qe te paguaj shumen prej 20 Euro, me që gjykatës i mungonin te dhëna tjera sipas listës definitive te shpenzimeve te procedurës, pasi qe te sigurohen këto te dhëna gjykata do te vendose me aktvendim te veçantë.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike nuk i ishte parashtruar gjykatës, prandaj edhe gjykata vetëm ka konstatuar se nuk kishte kërkesë pasurore-juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248,365,450, e 461 te KPPK-ës nga arsyet e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Krimeve te Renda

P.nr.61/17 dt.17.11.2017

Procesmbajtësja  
Xhemile Babatinci

Kryetari i trupit gjykues  
Burim Ademi

**Këshillë juridike:** Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine- Departamenti i Krimeve te Rënda e nëpërmes kësaj gjykate.